



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr.979/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të thyrjes së heshtjes zgjedhore, për Raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike Kosovës (PDK), dega në Ferizaj.

### **Arsyetim**

Me datën 01.12.2013, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se me datën 01.12.2013, në ora 07:43 në fsh. Surqinë subjekti politik LDK ka të vendosur një poster të kandidatit për kryetar Muharem Sfarqa brenda hapsirës e cila është e ndaluar në Qendrën e Votimit nr.2524D në këtë fshatë. Kjo bie ndeshë me rregullën zgjedhore nr.13/2013 fushat e zgjedhjeve dhe njoftim për ngjarjet politike neni 8.3,dhe Ligji për Zgjedhjet e Pergjithshme në Kosovë, neni 36. Si dhe ka të bashkangjitura katër fotografi si deshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik më datën 02.12.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 03.12.2013 deri në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK me të cilën konsideron se janë të pabaza pretendimet e PDK-së, sepse fotot të cilat janë ofruar si provë materiale vërtetojnë se posterët e pretenduar janë të vendosur me herët dhe nuk përbëjnë shkelje të rregullës zgjedhore thyrje të heshtjes zgjedhore, poashtu është obligimi i menaxherit të qendresë së votimit që të bejë pastrimin e zonës dhe të garantojë që mos të ketë materiale propagandistike brenda zonës prej 100 metra ne perimetrin e qendrës së votimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## **Ankesa është e pabazuar**

PZAP- konstatoi se pretendimet ankimore se subjekti politik LDK, ka vendosur posterin e kandidatit për kryetarë në afërsi të Qendrës së Votimit në fshatin Suriqinë, nuk qëndrojnë nga dëshmitë e ofruara nuk ka qenë e mundur te identifikohet se në çfarë afërsie është vendosur posterin e kryetarit të subjektit politik LDK, siç pretendohet në ankesë, andaj një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 979/2013 më datën 04.12.2013.



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i